



## **Kushtet e përgjithshme për themelimin e marrëdhënies për parapaguese për përdorim të shërbimeve të MTEL DOOEL Shkup**

### PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Dispozitat themelore
3. Termat dhe definicionet
4. Palët kontraktuese në kontratën për marrëdhënie parapaguese
5. Lidhja dhe aktivizimi i shërbimit
6. Të dhëna për parapaguesin dhe shërbimi që sigurohet
7. Çmimet dhe pagesa
8. Mbledhja e të arkëtueshmeve nga OPERATORI
9. Obligimet dhe përgjegjësitë e OPERATORIT
10. Rregullat për përdorimin e shërbimeve të OPERATORIT
11. Ankesat e abonentit
12. Ndërprerja e përkohshme e shërbimit të siguruar
13. Kohëzgjatja dhe ndërprerja e kontratës
14. Informacioni dhe mbështetja për parapaguesit
15. Dispozitat përfundimtare



## KAPITULLI I DISPOZITAT HYRËSE

1.1. Kushtet e përgjithshme për vendosjen e marrëdhënies parapaguese dhe shfrytëzimin e shërbimeve të OPERATORIT MTEL DOOEL - Shkup (në tekstin e mëtejme Kushtet e përgjithshme) i përmbajnë dhe i rregullojnë kushtet e përgjithshme të marrëdhënies standarde të parapaguesit për vendosjen e marrëdhënies parapaguese për sigurimin e qasjes në rrjetin publik të komunikimit dhe shfrytëzimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike (në tekstin e mëtejme kontrata), duke i përfshirë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, në mënyrë që shërbimi i komunikimit elektronik DTH (Direct to home) të realizojë distribuimin e programe televizive nëpërmjet satelitit deri te përdoruesit e fundit të paketuar në m:SAT servis.

Këto Kushte të Përgjithshme janë në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike, Rregulloren për Llojin dhe përmbajtjen e të dhënave dhe informacionin për kushtet e përgjithshme lidhur me qasjen dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimit publik të publikuara nga operatorët dhe llojin e përmbajtjen e të dhënave që do të publikohen nga Agjencia për komunikime elektronike (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), si dhe me rregullat dhe rregulloret tjera relevante.

OPERATORI MTEL DOOEL Shkup (në tekstin e mëtejme: OPERATORI) mundet, veçanërisht nëse kushtet e tregut ose rregullorja ligjore e imponojnë ndryshimin dhe/ose plotësimin e këtyre Kushteve të përgjithshme.

Këto Kushte të Përgjithshme dhe ndryshimet e tyre janë në dispozicion për inspektim në çdo pikë shitjeje të OPERATORIT, si dhe në faqen e internetit [www.mtel.mk](http://www.mtel.mk)

Si pjesë përbërëse e këtyre Kushteve të Përgjithshme konsiderohen të dhënat elektronike nga të dhënat e OPERATORIT për aktivizimin dhe çaktivizimin e disa paketave televizive bazë dhe shtesë, si dhe të dhënat për aktivizimin dhe çaktivizimin e kryer duke telefonuar në numrin pa pagesë 15010 të Kontakt Qendrës të OPERATORIT.

Këto Kushte të Përgjithshme do të zbatohen nga dita e publikimit të tyre në faqen e internetit [www.mtel.mk](http://www.mtel.mk) dhe do të vlejnjë për të gjithë abonentët, të cilët janë përdorues të fundit të shërbimeve publike të komunikimit elektronik të OPERATORIT pas kësaj date.

Në bazë të kushteve dhe kritereve të njohura prej më parë, parapaguesi mund të lidhë marrëveshje komerciale shtesë për përdorimin e shërbimeve të OPERATORIT, me të cilat mund të parashihen të drejta dhe detyrime që janë të ndryshme nga ato të shënuara në Kushtet e Përgjithshme në fuqi.

Dispozitat e rregulloreve në fuqi zbatohen për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet OPERATORIT dhe parapaguesve që nuk rregullohen nga këto Kushte të Përgjithshme.

## KAPITULLI II DISPOZITAT THEMELORE

Këto kushte të përgjithshme (në tekstin e mëtejme: Kushtet e përgjithshme) kanë të bëjnë me sigurimin e shërbimit m:SAT TV dhe i rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet MTEL DOOEL Shkup (në tekstin e mëtejme: Operatori), si siguruesi i shërbimit m:SAT TV dhe parapaguesve të atij shërbimi dhe i përcaktojnë kushtet standarde për të siguruar shërbimin e përmendur.

Shërbimi m:SAT TV përfshin dorëzimin të programeve televizive nëpërmjet satelitit të pajisja përkatëse, gjegjësisht antena satelitore me LNB dhe një pajisje marrëse e quajtur SetTopBox ose modul me qasje me kusht (në tekstin e mëtejme pajisje terminale) të instaluar në lokacionin e parapaguesit, ku përmbajtja e programit është e organizuar në paketa televizive. Kushtet e përgjithshme dhe specifikimet e paketave televizive në kuadër të Shërbimit, karakteristikat e detajuara teknike të Shërbimit, si dhe lista e çmimeve të Shërbimit (në tekstin e mëtejme: Lista e çmimeve), janë në dispozicion për publikun, në përputhje me rregulloret në fuqi, në faqen e internetit [www.mtel.mk](http://www.mtel.mk), si dhe në pikat e shitjes së OPERATORIT.

Sigurimi i Shërbimit rregullohet përveç me Kushtet e Përgjithshme me kontratën për abonim (në tekstin e mëtejme: Kontrata), që lidhet me shkrim ndërmjet OPERATORIT dhe parapaguesit. Me nënshkrimin e Kontratës, Parapaguesi e pranon aplikimin e Kushteve të Përgjithshme, të cilat janë pjesë përbërëse e Kontratës.

Dispozitat e rregulloreve në fuqi zbatohen për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet OPERATORIT dhe parapaguesve, që nuk janë rregulluar me këto Kushte të Përgjithshme.

OPERATORI siguron shërbim të komunikimit elektronik në përputhje me Ligjin për Komunikime Elektronike (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe aktet nënligjore. Shërbimet publike të komunikimeve elektronike janë në dispozicion për çdo përdorues sipas kushteve jo-diskriminuese, objektive dhe transparente, me përjashtim të rasteve të kufizimeve që kanë të bëjnë me kapacitetin e Operatorit.

OPERATORI nuk do të refuzojë të plotësojë kërkesën e arsyeshme për shërbim të komunikimit elektronik nga secili erson që është i gatshëm të pranojë dhe respektojë kushtet për përdorimin e shërbimeve të Operatorit.





